

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e shtatë e K.K-së,s, e cila do të mbahet më 28.07.2022 (e enjte) duke filluar në ora 10:00h.


R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Raporti i Drejtoris së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022;
3. Raporti financiar për tremujorin e dytë prill - qershor 2022;
4. Aprovimi i raportit të punës për gjashtëmujorin e parë të Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
5. Me propozim të Drejtorisë së Financave, shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për transferimin e mjeteve sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2022. nga rezerva e kategorisë ekonomike tek investimet kapitale;
6. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës zt.Sasa Milsovic për formimin e KKSB-së;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne Sallen e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 21.07.2022
Në: Novobërdë

zonj.Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 30.06.2022, duke filluar në orën 10:10.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, zv. Kryesuesi i Kuvendit zt. Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës për Komunitete zt. Bajrush Ymeri, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrovoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Abdyl Gashi, Ivica Cenic, Drejtori i Financave zt. Milos Denic, Drejtori i Administratës zt. Serboljub Djokic, Drejtori i Shendetësisë zt. Goran Simijonovic, Drejtori i Bujqësisë zt. Sillobodan Savic, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi tha: konstatoj korumin prezent janë 13 anëtarë nga 15 anëtarë gjithësej të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Formimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;
3. Formimi i komisionit për ankesa (në kuader të komisionit për zgjedhje të këshillave të fshatrave);
4. Raporti i Drejtorit të Financave rreth mbajtjes së debateve publike për KAB 2023/25;
5. Aprovimi i KAB-it 2023/25;
6. Raportim nga ana e Drejtoratit të Bujqësisë rreth planit për korje-shirje 2022;
7. Raportim nga Drejtoria e Sherbimeve Publike – Departamenti për mbrojtje të ambientit rreth gjendjes me deponi ilegale;
8. Raportim nga komisioni nga gjendja e jashtzakonshme dhe e komisionit vlerësues të dëmit në bujqësi;
9. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: para se të aprovojim rendin e ditës ju njoftoj se i kemi edhe tri pika shtesë të propozuara:

1. Anulimi i vendimit për plotësim ndryshim të statutit të Komunës nr.01/563 dt.07.06.2022;
2. Formimi i Komisionit për plotësim ndryshim të statutit;
3. Marrëveshja e bashkpunimit në mes të Komunës së Novobërdës dhe Kamenices;

Kryesuesja i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite dhe këto pika shtesë të propozuara apo keni ndonjë diskutim?.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: për këtë rend dite për propozimet shtesë besoj se kemi të drejt që të bëjmë debat, për pikën numer 1 për anulimin e vendimit po më vjen mirë Kryesuese që është kthyer ky vendim pasi që këshillat nuk i ke marrë ashtu siç duhet, heren e fundit keni bërë shkelje të rregullores së Kuvendit pasi që nuk ma

Procesverbali i Kuvendit

keni dhënë fjalën mu konkretishtë, por sa i perket shuarjes të një Drejtorie me u ndrru statusi i Komunës pa asnjë bazë ku më e rëndësishme është Drejtoria e inspeksionit të funksionoj pasi që i dim të gjitha këto probleme që i ka Komuna e Novobërdës, unë votoj kunder për piken e dytë për formimin e komisionit për ndrrimin e statutit. Kryesuesja tha: për piken e parë dhe të dytë duhet të shkoj në zyren ligjore e pastaj do të verifikohen. Ne nga Ministria kemi marrë shkresën percjellëse se vendimi nuk i'u është përmbajtur disa procedurave ligjore prandaj duhet që ta anulojmë, egziston rregullorja se si janë procedurat për plotësim dhe ndryshim të statutit, komisioni është kompetent për plotësim ndryshim e pastaj ne do ta shohim se a është në pajtim me ligjin. Ju e dini se rendin e ditës e bënë Kryesuesja e Kuvendit në bashkpunim me Kryetarin e Komunës me propozimet e anëtrave të Kuvendit, unë si Kryesuese mundohem të jem transparente dhe çdo pikë që na vjen për rend ditës të jetë në pajtim me ligjin. Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: besoj se nuk është vendimi i parë që e kthen MAPL-ja, ky Kuvend dhe ky institucion ka nevojë për këshilltar juridik pasi që ju si Kuvend po bini shumë posht edhe pse unë kam qenë kunder këtij vendimi pasi që po kthehen që 3-4 vendime brenda këtij viti. Në mbledhjen e kaluar dola në foltore për ta kundërshtuar një vendim të tillë ku Kryetari deshiron ta shuaj Drejtorin e Inspeksionit ku e dim se është një ndër shtyllat kryesore ndërsa e vetmja arsye është më i ik përgjegjës disa individ të caktuar. Pa bërë bartjen e pronave nga toka bujqësore në ndertimore kanë lejuar ndërtime dhe e kanë shendrruar Komunën në një kaos. Ne si Komunë ende nuk e kemi një rregullore për ndërtim, deri sa ndertohen villa në të gjithë Komunën, andaj i lus të gjithë asambleistat që mos të votojnë një komision të tillë, është edhe komisioni për emrimin e rrugëve por askush nuk u mirrë me atë komision. Tash e kemi komisioni për këshillat e fshatrave, unë deshiroj që të mirren shumë seriozishtë që të punohet me emërimin e Kryetarëve për këshillat e fshatrave, ju faleminderit. Pasi nuk pati diskutime tjera me 11 vota për dhe 2 apstenime aprovohet rendi i ditës më propozimet shtesë për rend dite.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: sa i perket procesverbalit nga mbledhja e kaluar nuk është shkruar ashtu siç ka qenë realishtë mbledhja e kaluar, nuk janë shkruar reagimet dhe fjalët të cilat i kemi thënë ne, unë si asambleist komunal kam kërkuar të drejtën e fjalës dhe ma keni mohuar ju si Kryesuese e Kuvendit, është duhur që ta shkruani reagimin tim të cilin e kam bërë dhe unë jam kunder këtij procesverbalit.

Kryesuesja tha: nga sot tju them se mbledhja e Kuvendit do të ingjizohet dhe transmetohet në ëeb faqe dhe çdo mbledhje do të jetë publike.

Pasi nuk pati vërejtje tjera aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar e Kuvendit me 11 vota për dhe 2 kunder (Abdyl Gashi dhe Selatin Nuhiu).

Pika e dytë: Formimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

Kryesuesja tha: ju njoftoj anëtar të nderuar se gjatë muajve të ardhshëm duhet të fillojmë me zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe për të filluar me procedurat së pari duhet ti fillojmë dy komisione pra që i kemi në piken e dytë dhe të tretë në rend dite. Te komisioni i parë i kemi shtatë anëtarë, katër anëtar nga Kuvendi, 1 nga organi ekzekutiv dhe 1 nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatrave. Ndërsa komisioni i dytë i ka 3 anëtarë nga Kuvendi. Para se të hapim diskutimin të bëjmë një pauzë në mënyrë që të bisedojmë për përbërjen e komisioneve.

Pas pauzës 10min Kryesuesja tha: e bëmë këtë pauzë që të kemi propozimet dhe në bashkëpunim me kolegët kam marrë propozimet ndërsa sa i perket antarit të 7 në çdo fshat është përfaqësuesi i atij fshati. Propozimet nga anëtarët e Kuvendit për komisionin e zgjedhjes së këshillave të fshatrave janë: Milica Jovanovic, Vlora Vllasaliu, Negovan Jovanovic, Abdyl Gashi, Slavica Stankovic nga këshilli ekzekutiv, Vesna Staic nga shoqëria civile dhe anëtar i shtatë përfaqësuesi i fshatrave. Komisioni për ankesa: Dragana Dimic, Ramush Mehmeti dhe Violeta Milosevic.

Pasi nuk pati diskutime nga 13 antarë të Kuvendit prezent, 13 votuan për formimin e këtyre dy komisioneve dhe mirren këto:

VENDIME

- I. APROVOHET vendimi për formimin e komisionit për zgjedhje të këshillave të fshatrave.
- II. APROVOHET vendimi për formimin e komisionit për ankesa.

Pika e katërt: Raporti i Drejtorit të Financave rreth mbajtjes së debateve publike për KAB 2023/25;

Kryesuesja tha: e kemi pasur edhe në KPF-ë këtë pikë që është komiteti këshilldhënës ka qenë ZKF për raportim, në këto debate duhet të jetë edhe Kryesuesja e KPF-së, e di se janë mbajtur 5 debate në fshatrat e Novobërdës dhe ja kaloj fjalën Drejtorit të Financave zt. Milos Denic.

Procesverbali i Kuvendit

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket kësaj pike rreth mbajtjes së këtyre debateve, debatet janë mbajtur në Stanishor, Kufc, Llabjan, Zebinc dhe Bostan, kemi pasur një numer të konsiderueshëm të qytetarëve kemi shpall ftesen në ëeb faqe të Komunës për debate. Ne debate ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së bashku me ne nga Drejtoria për buxhet dhe financa dhe ai ka mundur ti ndegjoj kërkesat e qytetarëve në këto debate. Qëllimi i këtyre debateve ka qenë që ti ndegjoj kërkesat dhe problemet e qytetarëve e kan të bëjnë me investimet kapitale. Problemet e qytetarëve kryesisht kanë të bëjnë me infrastruktur rrugore, ndriqim dhe problemet e ujit, kështu që në bazë të kërkesave të tyre që i kemi pasur së bashku me Kryetarin dhe Drejtorat e kemi pregaditur këtë KAB.

Kryesuesja tha: e dim se Komuna e Novobërdës është me teritor të madhë dhe këto debate kanë qenë të nevojshme që të ndegjohen problemet e qytetarëve tonë.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: pas degjimeve publike që keni mbajtur cilat janë kërkesat e tyre të evidentuara që pastaj i paraqitni në planifikimin tuaj buxhetor?.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja kaloi në piken tjetër të radhes.

Pika e pestë: Aprovimi i KAB-it 2023/25;

Edhe për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Drejtorit të financave.

Milos Denic tha: para jush e keni KAB 2023/25, buxheti për vitin e ardhshëm është më i madhë se këtë vit. Buxheti total për vitin e ardhshëm është 3,329,629.00€, të ndara në kategori paga dhe meditje 2,181,144,00€, mallra dhe sherbime 415,781.00€, Komunal 90,000.00€, në Subvencione 260,000.00€, në investime kapitale 382,707.00€. Sa i perket kategorisë së subvencioneve kemi një rritje që e kemi paraqitur edhe në tabel, ndërsa në faqe 16 është lista e projekteve që e kemi propozuar në bazë të kërkesave dhe nevoje.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: faleminderit Drejtor për raportimin e dhënë, te faqja 11 për ndarje të subvencioneve në vitin 2022 janë ndarë 52,990€ ndërsa në vitin 2023 qenka pesifshuar kjo shumë në vlerë prej 260,000€ po më duket një shumë e madhe nese ka mundësi Drejtor me na sqaru pak më shumë.

Milos Denic tha: në mbledhjen e kaluar e dini se e kemi aprovuar Rregulloren e subvencioneve, ku përfshihen subvencionet në të gjitha sektoret si në arsim, kultur, zhvillim ekonomik, bujqësi dhe shendetësi për këtë arsye edhe janë rrit subvencionet.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: e përgëzoj Drejtorin e Financave për mbajtjen e debateve me qytetarë pasi ma herët nuk janë mbajtur këto debate. Po më pelqen edhe forma e planifikimit të buxhetit pasi që është planifikuar me rritje dhe kjo rritje është me vend pasi që në atë rregullore janë planifikuar të ndahen edhe nga 100€ për nënat që lindin.

Pasi nuk pati tjera diskutime nga 12 anëtar prezent 12 votuan për këtë pikë dhe u murr ky:

VENDIM

APROVOHET Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025;

Pika e gjashtë: Raportim nga ana e Drejtoratit të Bujqësisë rreth planit për korrje-shirje 2022;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Bujqësisë zt.Slllobodan Savic.

Slllobodan Savic pasi pershendeti të pranishmit tha: këtë vit kemi vetem njoftimin nga Ministria ku përmes njoftimit thuhet se procesi i korrje-shirjes të jetë i mbikqyrur dhe i raportuar për çdo javë dhe do të formohet komisioni nga Drejtoria e bujqësisë që do ta mbykqyr këtë proces të korrje-shirjeve si dhe çmimi këtë vit për shkak të shpenzimeve të naftes do të jetë 130€ për hektar.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kam një pyetje për Drejtorin, këto dy viteve të fundit Komuna nuk ka marrë asnjë të hyrë nga Kombanjerët.

Slllobodan Savic tha: e di që gjatë viteve të fundit nuk kanë paguar kombanjeret taksa shtesë por as ne si Komunë nuk kemi kërkuar që të paguajn eaksa extra për arsye mos me hy në konfliktë.

Pika e shtatë: Raportim nga Drejtoria e Sherbimeve Publike – Departamenti për mbrojtje të ambientit rreth gjendjes me deponi ilegale;

Për këtë pikë ja dha fjalën Shefkije Mehmetiit.

Shefkije Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: raportin të cilin e keni marrë është për deponit ilegale, është i pregaditur nga zyrtarët e Komunës dhe një zyrtarë i GIZ-it i një organizate jo-qeveritare gjermane. Raporti është i

Procesverbali i Kuvendit

pregaditur për vitin 2020 dhe 2021 dhe i njeiti raport është pregadit edhe për vitin 2022 pasi që nuk ka asnjë ndryshim. Ne këtë vit e kemi bërë një ndryshim pasi që kemi pasur pak mjete e kemi bërë hapjen e tenderit për kargimin e dy deponive me të mëdha në teritorin e Komunës sonë në Stanishor dhe Koretishtë. Në raport i keni të gjitha deponitë ilegale, por ne për arsye të buxhetit nuk kemi pasur mundësi që ti eliminojm të gjitha deponitë ilegale pasi që e diem se terreni ynë është shumë i madhë dhe ka shumë deponi.

Kryesuesja tha: siç e diem të gjithë ne kemi problem shumë të madhë me të gjitha këto deponi, sidomos në fshatrat që janë afër qytetit të Gjilanit, kam qenë në terren dhe kam biseduar më të gjithë si me qytetarët, inspeksionin, Kryetarin, inaoëkaioni çdo ditë është në terren dhe kjo është e mirë. Për fat të keq në Koretishtë kemi 4-5 deponi të mëdha, me kamiona të mëdha vin dhe hudhin mbeturina dhe çdo kufi është kaluar, si me gurthyesit ashtu edhe me ndotjen e ambientit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: ne e kemi një raport dhe ky raport i ka të gjeturat e sakta si dhe ka shumë e më shumë deponi ilegale dhe Komuna jonë po kalon rrjedhimisht ne deponi të mbeturinave nga Komunitet e tjera dhe kjo është arsyeja që unë kundërshtova më herët shuarjen e Drejtorisë së Inspeksionit. E kemi tregun e kafshëve në Llabjan ku i therrin kafshët dhe të gjitha mbeturinat mbesin aty, aty afer e kemi shkollën e mesme, sallën e sportit, ambulanten, prandaj është e domosdoshme që edhe Komuna të gjej bashkpunim edhe me qytetarët që kur te shohin duke hedh mbeturina të lajmërojnë.

Kryesuesja tha: dje kam biseduar me inspektoriatin dhe pasi që janë në terren kam ërkuar që një nga mbledhjet të jenë prezent dhe të raportojnë.

Shefkije Mehmeti tha: sa për njoftim edhe ne si Drejtori e Sherbimeve Publike së bashku me inspektoriatin jemi çdo ditë në terren pasi që kemi shumë raste të ndotjes së ambientit, së fundmi kemi pasur një hapje të kanalizimit afer rrugës dhe i kemi detyruar që ta mbyllin. Ne jemi munduar që ti mbajm nënë kontroll edhe me polici kemi bashkpunim të mirë.

Stojan Sanojevic tha: e kemi edhe një problem sa i perket mbeturive pasi që ka 2-3 muaj që nuk janë pastruar kontinjeret, ju lutem ta njoftoni kompanin që ti bartin mbeturinat.

Kryesuesja tha: kerkoni një raport nga EcoHigiena që të raportoj rreth gjendjes në terren.

Pika e tetë: Raportim nga komisioni nga gjendja e jashtzakonshme dhe e komisionit vlerësues të dëmit në bujqësi; Për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Bujqësisë Slllobodan Savic.

Slllobodan Savic tha: sa i perket gjendjes së jashtzakonshme që ka qenë i kemi 30 kërkesa nga fermeret për kompensim të dëmëve, jemi duke i mbledhur kërkesave në mënyrë që ti dergojm pastaj në Ministri të Bujqësisë pasi që nuk e di Komuna sa ka mundësi që t'ju ndihmoj këtyre rasteve.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: unë i falenderoj anëtarët e KPF-së që e kanë inicuar këtë pikë që të jetë në rend dite në këtë Kuvend, ku Drejtorja e Bujqësisë na jep një raport pak më të saktë, e di që është një afat i shkurtë por nuk murrem asnjë pergjigje, kerkoj ta dij, se sa është shumë e shkatuar nga dëmi?, a ka dëme edhe në shtepi banimi?, me e pas më shumë të detajuara.

Slllobodan Savic tha: sa i perket këtyre dëmëve nuk është i përfshir i gjithë teritori i Komunës, është përfshier një pjesë e Llabjanit, e Koretishtes, Paralloves dhe një pjesë të Pasjakit. Sa i perket objekteve ndertimore ne nuk jemi kompetent për atë punë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: pas vlersimit të këtyre dëmëve a keni planifikuar buxhet për kompensim të këtyre dëmëve?, pasi që fermeret janë dëmtuar shumë dhe kërkojnë ndihme mbështetje. Kemi vërejtje në komisionin i cili nuk ka dal te fermeret shqiptarë, nuk ka nevoj me bë ndarje të fermereve në bazë të nacionalitetit, kemi pranuar shumë ankesa nga fermeret dhe kjo është e jashtligjshme Drejtor.

Slllobodan Savic tha: sa i perket komisionit kanë qenë te të gjithë bujqit që kanë parashtruar kërkesa dhe ankesa, kemi shumë qytetarë që kanë thirr në telefon, ndoshta nuk kemi qenë të bujqët që kanë 1 ari e më pak por kemi qenë te ata me serioz qe i kemi në regjister, nese dikush ka mbetur pa u vizituar natyrisht se do të vizitohet, edhe më tutje po vazhdojm të pranojm kërkesa dhe po vazhdojm të dalim në terren.

Pranvera Kastrati Gashi tha: nuk pata ankesa nga fermeri që ka 1 ari apo 2 ari, por pata ankes nga fermeret që kanë me hektarë dhe nuk keni dal me i vizitu fare.

Ramush Mehmeti tha: me vet faktin se KPF-ja e ka sjell këtë pikë këtu është një iniciativ shumë e mirë, edhe unë jam i demtuar me hektar por nuk kam aplikuar si fermer, por e lus drejtorin që të kërkoj ndihmë nga Ministria pasi që përmes buxhetit Komunal është e pamundur që të kompensohen të gjitha këto dëme.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesja tha: i patem 4 raporte nga Drejtorat pra po e shihni se kemi një bashkpunim të mirë.

Shefkije Mehmeti tha: vetem nj informat pasi që edhe unë jam pjesë e atij komisioni, ne si komision kemi dal në terren por ende skemi pregaditur raport pasi që kemi ende kërkesa. Raportin do ta sjellim në ndonjë nga mbledhjet me fotografi emer dhe mbiemer dhe vleren e dëmeve.

Pika e nëntë: Anulimi i vendimit për plotësim ndryshim të statutit të Komunës nr.01/563 dt.07.06.2022;

Kryesuesja tha: këtë vendim na ka kthyer MAPL-ja dhe duhet që ta anulojm pasi që nuk kemi më shumë kohë, pra duhet që ta anulojm këtë vendim e pastaj të fillojm me procedurat për ndryshim plotësim të statutit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime nga 12 anëtar të Kuvendit prezent 12 votun për këtë pikë dhe u murr ky:

VENDIM

Anulohet Vendimi me nr Protokoli 01/563 i dates 07.06.2022 për Ndryshim Plotsim të Statutit të Komunes gjegjesisht nenit 69.

Pika e dhjetë: Formimi i Komisionit për plotësim ndryshim të statutit;

Kryesuesja tha: komisioni i ka 7 anëtarë por do të bëjmë një pauz për propozimet e anëtarëve të komisionit, por para pauzes t'ju lexoj rregulloren se ndryshimi i statutit bëhet me 2/3 e votave të Kuvendit, në bazë të kësaj rregullore duhet të formohet një komision me këtë përbërje: anëtarët e kuvendit, anëtarët e organeve ekzekutive, një përfaqësues i OJQ-ëve dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Kryesuesja propozoi pauz 10 min për tu kordinuar rreth përbërjes së anetërve të komisionit.

Pas pauzes.

Kryesuesja tha: gjatë pauzes i kam marrë propozimet nga anëtarët e Kuvendit dhe këto janë: Ramush Mehmeti, Ivica Cenic, Ivana Ivanovic, Pranvera Kastrati Gashi, nga këshilli ekzekutiv Sllagjana Natic, Dragana Stojanovic dhe nga sektori civil Jovan Simic.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime nga 11 anëtarë prezent, 10 votuan për dhe 1 apstenim aprovohet kjo pikë dhe mirre ky:

VENDIM

Për emrimin e komisionit për zhvillim dhe mbikqyrje të hapave për pregaditjen e statutit të komunes së Novobërdesme nr.01/992 të dates 01.10.2012

Pika e njëmbëdhjet: Marrëveshja e bashkpunimit në mes të Komunës së Novobërdës dhe Kamenices;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Goran Simijonovic.

Goran Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: siç e permenda më herët bëhet fjalë për një marrëveshje ndërkomunale me Komunën e Kamenicës dhe unë shkurtimisht do ta prezantoj këtë marrëveshje për mos t'ju marrë shumë kohë se ndoshta jeni të lodhur. Bëhet fjalë për shtegun e biciklisteve ku vlere e projektit është prej 399,960.40 euro, ku pjesen prej 299,960.40 euro e financon MAPL, ndërsa pjesën prej 100,000.00 euro e bashkëfinancojnë Komuna e Kamenicës me 98,000.00 euro dhe Komuna e Novobërdës me 2,000.00 euro. Ajo që është e rëndësishme duhet ti paraqesë është për obligimet e Komunës së Novobërdës të cilat janë: 1. Komuna e Novobërdës siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve me të cilat mer pjesë në financimin e projektit, në shumën prej 2,000.00 euro.

2. Komuna e Novobërdës obligohet që për pjesën e projektit që zhvillohet në teritorin e saj, t'i krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit për operatorin ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesa të filloj në implementimin e projekteve me kohë.

5. Komuna e Novobërdës emëron nje projekt menaxher/organ mbikëqyrës për inspektimin /pranimin e punimeve, për pjesën e projektit që zhvillohet në teritorin e saj.

6. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

7. Komuna e Novobërdës duhet të ndërmarr të gjitha masat që projekti të përfundoj mbrenda viti fiskal 2022. Gjatësia e këtij shtegu është 10km dhe një pjesë është edhe në teritorin e Komunës sonë.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesuesja tha: mirë është pasi që kemi filluar të punojm diçka, duhet ta ndertojm dhe zhvillojm turizmin, ajo që është nga fushat e turizmit edhe ky shteg duhet të filloj dhe mendoj se është shumë marrëveshje e mirë për bashkpunim me Komunën.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Bojan Peric pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam një pyetje se cila pjesë e rrugës është zgjedhur për këtë shteg të biciklistave?, ky shteg a do të kaloj përmes rrugës kryesore? Po thuani se Komuna do të participoj 2,000€ por a duhet të blehet toka pasi që shumica e shtegun kalon nëpër pronë private dhe do të dalin edhe disa qështje por kjo pyetje e parë. A shkon përgjat rrugës kryesore si dhe në këtë projekt duhet të bëhen edhe disa pushimore për ciklist nese dalin në natyrë e lus Drejtorin për sqarime shtesë.

Goran Simijonovic tha: sjom për detale i njoftuar por sa kam pasur qasje, pika fillimore është nga Busavata në Jasenovik dhe besoj se 90 % nuk është në pronë private por është shtetërore është përgjatë rrugës kryesore dhe nese ndodhë ndonjë nevoj për kompenzim për pronë private, sbesoj që ka lëshime.

Dobriboje Djordjevic tha: lidhur me këtë projekt a ka bicikleta apo nuk ka?, kush do ti vozit ato bicikleta?.

Pasi nuk pati diskutime tjera nga 10 anëtarë prezent 8 votuan për, dhe 2 kunder (Negovan Jovanovic dhe Dobriboje Djordjevic) dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET vendimi për bashk - realizimin dhe Financimin e projektit ndërkomunal në mes të Komunes së Novoherdes dhe Kamenices per ralizimin e projektit "Shtegu i Biciklistve".

Pika e dymbëdhjet: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: fshati Izvor është fshati më i vjeter në teritorin e Komunës, nese ka mundësi ta fusni në listen e projekteve njeran mahall për ndriqim publik pasi që ka tri mahalla të ndara, ju faleminderit.

Stojan Stanojevic tha: i falenderoj të gjithë Drejtorët që për gjatë gjithë muajve kanë qenë prezent, por kerkoj që edhe Drejtori i Arsimit të jetë prezent dhe kam të drejt të kerkoj sipas statutit të futet në rend dite që në Kuvendin e ardhshëm të jetë edhe Drejtori i Arsimit këtu. Për mendimin tim është e pakuptueshme që një drejtor të mos vijë dhe të raportojë në Kuvend për shtatë muaj. Gjatë dimrit kishte problem me drutë. Ne ulemi këtu, jemi dakord, votojmë, por nuk kemi një drejtor që të na raportojë. Dua t'i lus kryesuesit që ta vërë në votim që Drejtori i Arsimit të jetë këtu për Kuvendin e ardhshëm, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: pasi që rendi i ditës bëhet nga Kryesuesja e Kuvendit me Kryetarin e Komunës dhe anëtarët dhe nese keni ndonjë propozim për rend dite keni të drejt të kërkonit pika shtesë.

Kryesuesja e hudhi në votim propozimin e Stojan Stanojevic dhe me 8 vota për, 2 apstenime aprovohet që në mbledhjen e ardhshme të raportoj Drejtori i Arsimit.

Violeta Milosevic tha: edhe në fshatin Jasenovik nuk kemi ndriqim publik.

Milica Jovanovic tha: i keni pasur 4 debate por nga fshati Parallov nuk kanë pasur mundësi që të marrin pjesë në këto debate.

Negovan Jovanovic tha: fshati Prekovic të shkolla qe një vit e gjysëm nuk punon ndriqimi.

Bojan Peric tha: e keni një kërkesë nga Nexhmedin Beqiri për bartje të rrugës, nese do ta bëni bartjen e kësaj rruge do ta shfrytëzonte pasi që tani kjo rrugë është e pashfrytëzuar.

Kryesuesja tha: edhe më herët kemi pasur kërkesa të tilla dhe kanë qenë prezent vet qytetarët që ti prezantojnë kërkesen e tyre.

Bojan Peric tha: në mbledhjen e ardhshme do të vij.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

